



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 16
Prishtinë, më 23 shtator 2015, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N- 303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Besnik Bislimi, Ali Sadriu, Duda Balje, Adem Grabovci, Hajdar Beqa, Naim Fetahu, Synavere Rysha, Bali Muharremaj dhe Valdete Bajrami.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatorë e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi, Mentor Hyseni, ekspert nga GIZ-i, dhe Arjeta Luli, praktikante.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil, Dritan Gjonbalaj- (AAC), Besmir Kokollari- Instituti i CHAT, Sanije Berisha – OSBE, Kaltrina Ahmeti- GLPS, Ibrahim Gylderren- ZAP, Artan Canhasi- KDI, Bujar Bajraktari- ZAP, Zuke Zuka- ZAP, Artan Venhari- ZAP, Qëndresa Mulaj- ZAP.

Mbledhjen e kryesoi: Besnik Bislimi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.07.2015;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës;
4. Shqyrtimi i rekomandimeve të dala nga Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014 për Ministrinë e Integritetit dhe Evroplane;
5. Shqyrtimi i rekomandimeve të dala nga raportet e Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014, dhe raportet e Performancës për mirëmbajtjen dhe servisimin e veturave zyrtare për: MAP, KGJK, Doganë dhe Policinë e Kosovës;

6. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare për Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2014;
7. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Pasqyrat Vjetore Financiare të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014;
8. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Pasqyrat Vjetore Financiare të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014;
9. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Pasqyrat Vjetore Financiare të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014;
10. Të ndryshme;

Rend i ditës:

Kryetari, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.07.2015

Kryetari- konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 29.07.2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

Kryetari- konstatoi se, me kërkesë të anëtarëve të komisionit, kjo pikë shtyhet për mbledhjen e ardhshme, ku do të ftohen përfaqësuesit e Ministrisë së Financave.

4. Shqyrtimi i rekomandimeve të dala nga Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014 për Ministrinë e Integrimeve Evropiane

Kryetari- theksoi se në mbledhjen e mbajtur më 29.07.2015, komisioni ka shqyrtuar raportin e auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare për MIE dhe ka vendosur që raportin së bashku me rekomandimet e KMFP t'i adresojë për seancë plenare. Këto rekomandime i hodhi në votim.

Përfundim

Komisioni i miratoj Rekomandimet e dala nga Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Integrimeve Evropiane, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014, dhe vendosi që ky Raport me rekomandime të adresohet për seancë plenare.

5. Shqyrtimi i rekomandimeve të dala nga raportet e Auditimit për Pasqyrat Vjetore

Financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014, dhe raportet e Performancës për mirëmbajtjen dhe servisimin e veturave zyrtare për: MAP, KGJK, Doganë dhe Policinë e Kosovës

Kryetari- Theksoi se në mbledhjen e mbajtur më 29.07.2015, komisioni ka shqyrtuar raportin e auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014, dhe raportet e Performancës për mirëmbajtjen dhe servisimin e veturave zyrtare për: MAP, KGJK, Doganë dhe Policinë e Kosovës dhe ka vendosur që raportin së bashku me rekomandimet e KMFP, t'i adreson për seancë plenare. Këto rekomandime i hodhi në votim.

Përfundim

Komisioni e miratoj Rekomandimet e dala nga Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Integrimeve Evropiane, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014, dhe raportet e Performancës për mirëmbajtjen dhe servisimin e veturave zyrtare për: MAP, KGJK, Doganë dhe Policinë e Kosovës, dhe vendosi që ky Raport me rekomandime të adresohet për seancë plenare.

6. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare për Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2014

Kryetari konstatoi se në mungesë të përfaqësuesve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, kjo pikë shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

7. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Pasqyrat Vjetore Financiare të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014

Kryetari- konstatoi se në mungesë të përfaqësuesve të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, kjo pikë shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

8. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Pasqyrat Vjetore Financiare të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014

Kryetari konstatoi se në mungesë të përfaqësuesve të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, kjo pikë shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

9. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Pasqyrat Vjetore Financiare të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014

Kryetari- Kemi prezent drejtorin e Autoritetit të Aviacionit Civil, z. Dritan Gjonbalaj, z. Ylber Aliu, drejtor i departamentit të administratës së burimeve njerëzore dhe zonjën Shqipe Selishta, këshilltare për buxhet dhe financa, të cilët i mirëpres dhe i falënderoj për gadishmërinë e tyre për raportim. Fjalën ia jap fillimisht auditorit që e ka kryer auditimin.

Ibrahim Gylderren- Ne e kemi kryer auditimin e rregullsisë për pasqyrat vjetore financiare për AAC- në për vitin 2014, është një institucion i vogël, me buxhet të ulët, me numër të limituar të stafit, opinioni ka qenë i pakualifikuar për pasqyrat financiare, do të thotë se ato kanë qenë në rregull. Sa i përket menaxhimit financiar dhe kontrollit, me disa përjashtime të vogla të natyrës teknike.

Kryetari- Ajo që më ka rënë në sy është se, auditori konstaton se të gjitha rekomandimet që i kanë bërë për vitin 2013 janë plotësuar në tërësi, që është një sinjal jashtëzakonisht i mirë, kisha dashur që në emër të komisionit ta përgëzoj AAC- në për gadishmërinë e tyre me bashkëpunu me auditorin dhe po ashtu dëshiroj të ju përgëzoj për punën që e keni bërë. Në raportin e auditorit shihet se ka vërejtje të vogla, si dhënja e licencave ndaj atyre që nuk i kanë kryer obligimet financiare ose ndonjë ngecje të kontrollit të brendshëm, a mundeni të na informoni shkurtimisht, se si mendoni t'i adresoni këto vërejtje që kanë dalë nga viti i kaluar.

Dritan Gjonbalaj- Më lejoni fillimisht të falënderoj Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, i cili është një institucion me të cilin kemi pasur bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë. Këtë vit ka pasur disa gjetje dhe disa rekomandime për t'u adresuar, gjetjet janë të vogla të natyrës teknike shumica prej tyre, e përmendët rastin e disa licencave që janë lëshuar të kontrolloret e trafikut ajror, për fat të keq kontrolli ajror në atë kohë nuk ka qenë në gjendje financiare që t'i paguaj këto licenca dhe ka një letërkëmbim të vazhdueshëm midis kësaj ndërmarrje publike dhe Ministrisë në të cilën ka qenë edhe AAC- ja. Pra ne kemi qenë para dy mundësive, ose të jemi kokëfortë në kërkimin e menjëhershëm të tarifës së licencës dhe mos t'i lëshojmë licenca për kontrollin e trafikut ajror, ose ti lëshojmë këto licenca që pagesa të bëhet brenda afatit të përcaktuar. Ne kemi zgjedhur që t'i lëshojmë këto licenca, sepse përndryshe pa licenca shërbimet nuk do të mund të ofroheshin dhe për pasoj do të kishim mbyllje të operimeve në aeroportin e Prishtinës. Me kënaqësi ju raportoj, se këto pagesa janë kryer nga kontrolli ajror Adem Jashari, pasi që janë transferuar si të arkëtueshme për këtë vit. Çështje tjera, kemi pasur blerje të dy kompjuterëve, pajisje të IT- së nga kategoria e furnizimit për zyrë, edhe kjo ka qenë një zgjedhe e detyruar për ne, në shkurt të vitit të kaluar Qeveria e Republikës së Kosovës ka emëruar zëvendës drejtorin e përgjithshëm të AAC- së, dhe ne në planin e përpunimit nuk kemi pasur të planifikuar blerje të pajisjeve të IT- së, kështu që i kemi shfrytëzuar mjetet në dispozicion që kemi pasur nga kategoria e mallrave për zyrë dhe kemi bërë blerjen e këtyre pajisjeve, mirëpo kemi mundësuar punën e zëvendës drejtorit të përgjithshëm. Çështje tjetër e ngritur në raportin e auditorit të përgjithshëm, ka qenë edhe dhënja e kredencialeve të inspektorit për një zyrtarë tonë, më lejoni të ju sqaroj se AAC- ja i ka specifikat e veta dhe kur punësojmë një zyrtar të aviacionit, ne nuk mund ta punësojmë menjëherë si inspektor, pa marrë parasysh se çfarë background akademik mund të ketë, sepse ne kemi rregullat e brendshme, që zyrtari i aviacionit duhet të kalojë nëpër një numër auditimesh të mbikqyera, pastaj auditime të pavarura dhe në fund të marrë rekomandimin pozitiv nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë. Ne kemi pasur fatin që si zyrtar të aviacionit me një konkurs të hapur të miratuar nga MAP, të marrim një person që ka përvojë shumë të madhe si menaxher i operimeve të sigurisë në aeroportin e Prishtinës, dhe ne brenda një viti kemi vendosur që t'i japim kredencialet e inspektorit,

me të drejtë ZAP e ka cilësuar si rritje në detyrë pa kaluar koha e kërkuar prej dy vitesh, mirëpo dhënjën e kredencialeve të inspektorit ne e shohim si konfirmim nga drejtori i përgjithshëm në bazë të ligjit ndërkombëtar të zbatuar edhe në vendin tonë, se zyrtari profesional i aviacionit i ka të gjitha karakteristikat profesionale për të kryer inspektime në mënyrë të pavarur. Gjithashtu është edhe një problem, kemi një zyrtar i cili kryen dy detyra, në departamentin e administratës është zyrtar i pasurisë dhe zyrtar i pranimi të mallit, e dimë që nuk është një zgjedhje e duhur, mirëpo kemi pak staf dhe e kemi të pamundur që personelin e administratës ta alokojmë në të gjitha detyrat shtese, duke mos pasur ndoshta edhe konflikt interesi, sidoqoftë ne kemi emëruar një zyrtar profesionist të aviacionit i cili është pilot, i cili tash do të kryej edhe detyrën e zyrtarit të pasurisë, me shpresë që kërkesa jonë drejtuar Qeverisë dhe Kuvendit të miratohet për punësim të një zyrtari shtesë në departamentin e administratës, do të ishte mënyra më e mirë për mbylljen e kësaj të gjeture. Në fund, ka edhe një komunikim rreth zyrës tonë për menaxhimin e cilësisë, ne kemi një zyrë për menaxhimin e cilësisë, kemi bërë zbatimin e standardit 2001-2008, i cili është kërkesë tashmë për AAC- në në BE dhe jemi certifikuar nga emri i kësaj zyre, mund të ketë edhe lajthitje se kjo zyre ka edhe përgjegjësi për auditimin e brendshëm të pasqyrave financiare, kjo zyrë nuk e ka atë përgjegjësi, kjo zyrë bënë auditimin e procesëve të punës në AAC. AAC- ja për shkak të buxhetit të vogël nuk i plotëson kushtet për të pasur njësi të brendshme të auditimit.

Valdete Bajrami- Kam një pyetje të shkurtër lidhur me prezantimin tuaj, ku patët rastin me treguar që keni një punëtor me dy punë, çfarë kontrate ka ai punëtori i juaj dhe a ka ndonjë punëtor që ende është me kontratë mbi vepër.

Dritan Gjonbalaj- Punëtori i cili është asistent i logjistikës, e që kryen edhe detyrë shtesë të zyrtarit të pasurisë, është shërbyes civil me kontratë, dëshiroj t'iu raportoj që në AAC- në nuk ka asnjë punëtor me kontratë mbi vepër.

Kryetari- Unë kam edhe një pyetje, te te hyrat që realizoni afër 1.4 milion, cila është struktura, sa vinë nga taksat e sigurisë, sa vinë nga licencat?

Dritan Gjonbalaj- Të dhënat e sakta nuk i kam me vete, mirëpo pjesa dërrmuese e të hyrave vjen nga tarifa për sigurinë e udhëtarëve dhe një pjesë e vogël vjen nga tarifa për licencim, certifikim dhe mbikëqyerje. Kjo është edhe si reflektim i nivelit të zhvillimit të industrisë së aviacionit. Tash për tash për shkak të problemeve me normalizimin e hapësirës ajrore, nuk kemi aktivitete të mëdha të aviacionit të përgjithshëm dhe për këtë arsye edhe numri i licencave të lëshuara nga AAC- ja nuk është i madh, dhe si rrjedhojë edhe të hyrat nga kjo kategori e të hyrave nuk janë të mëdha.

Ali Sadriu- Sa i përket auditimit të brendshëm, është shumë mirë që ju kërkonin një shërbim të tillë, duhet disa organizata ta kenë një auditor të brendshëm dhe nëse ju nuk keni mundur të gjeni dikë tjetër që ta keni bashkërisht një auditor, atëherë është mirë t'i drejtoheni edhe Njësisë Qendrore Harmonizuese. Gjithsesi unë ju përgëzoj për të gjitha këto rezultate që i prezantuat dhe shpresoj që vitin tjetër të jeni edhe më mirë.

Dritan Gjonbalaj- Tash e disa vjet ne auditohemi nga njësia e auditimit të brendshëm prej Ministrisë së Financave, bëjmë kërkesë në vazhdimësi, nuk e di nëse jemi në planin e tyre të auditimit, mirëpo jemi insistues që ata ta kryejnë auditimin e brendshëm.

Përfundim

Komisioni vendosi që Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014, të mos adresohet për seancë plenare.

10. Të ndryshme

Kryetari- Për ata të cilët nuk janë të informuar, komisioni në javën e dytë të muajit shtator ka pasur një vizitë studimore në Gjermani, në Bundestagun Gjerman. Gjatë kësaj vizite kemi pasur disa takime jashtëzakonisht të rëndësishme në komisionin për financa dhe komisionin për mbikqyrjen buxhetore brenda Bundestagut gjerman, kemi pasur takim me zyrën e auditorit gjeneral, respektivisht me përfaqësuesin e përhershëm të auditorit gjeneral gjerman në parlamentin e Gjermanisë, jemi takuar me kryeprokurorin për luftimin e korrupsionit në Landin e Berlinit, jemi takuar me kryesuesin e komisionit për hetimin e shkeljeve gjatë procesit të ndërtimit të aeroportit të Berlinit, kemi pasur edhe takime joformale me përfaqësues me rëndësi, miq të Kosovës brenda bundestagut gjerman dhe me ambasadën e Kosovës në Berlin, përgjithësisht ka qenë vizitë jashtëzakonisht e suksesshme dhe publikisht i falenderohem GIZ- it për organizimin e kësaj vizite, por edhe partnerëve tonë brenda Bundestagut dhe Landit të Berlinit që na kanë pranuar dhe na kanë ofruar mbështetje.

Temë tjetër, është edhe rekomandimet që ne i kemi dhënë Kuvendit të Kosovës, që të ecë me procedurat e auditimit të subjekteve politike, sekretaria e kuvendit na ka lutur që me përgaditë vetëm një rekomandim shtesë, në mënyrë që ata t'i gjejnë modalitetet që sa më shpejt të procedojmë.

Synavere Rysha- çështja sa i përket auditimit të pasqyrave të partive politike, është ngritë një grup i vogël punues, që është dashtur që të hartojë metodologjinë dhe format se si do të shkohet, mirëpo një takim që e kemi pasur ka qenë diku data tre qershor dhe prej atëherë më nuk jemi takuar, bashk me Hajdar Beqën jemi prej komisionit që në bashkëpunim me GIZ- in dhe sekretarinë e kuvendit duhet me i përgaditë modalitetet dhe formën se a do të shkohet me tender apo do të shkohet me kontratë në vepër.

Kryetari- A duhet ne, si komision, të përfshihemi, apo ne bëjmë shkelje ligjore, se fushëveprimi jonë është që me i dhënë rekomandime Kuvendit që me ecë me procedurë, pastaj është detyrë e stafit të kuvendit me i gjetë modalitetet se si do të procedojmë. Unë jam konsultuar edhe me ekspertë të auditimit, që Kuvendi ka hapësirë të mjaftueshme me gjetur modalitete për angazhimin e auditorëve.

Kaltrina Ahmeti- Para përfundimit të sesionit është përcaktuar grupi punues, ku si pjesë e grupit kam qenë edhe unë, si përfaqësuese e grupit për studime politike dhe juridike. Ne qysh në qershor kemi hartuar disa kritere dhe tema të referencës, për faktin se çka duhet

të merret parasysh, në rastin se kur të vendoset se si të përzgjedhën këta auditorë për subjektet politike.

Mentor Hyseni- Ne e kemi analizuar bazën ligjore si GIZ, nuk besoj që duhet që komisionet me përcaktuar diçka, sepse këto janë të përcaktuara komplet me ligj. Ligji për auditimin e partive politike mundëson me marr auditorë, veçanërisht edhe me aplikuar përmes kompanive, kështu që administrata e kuvendit mundet që menjëherë me shpall konkursin, me marr me kontratë në vepër, nëse dojmë me shkuar prapë qysh ka shkuar përpara përmes aplikimit të kompanive, ne prapë kemi me dështuar.

Ali Sadriu- Pas një diskutimi të gjatë i kemi nxjerrë kriteret e veprimit, është formuar grupi, ku në krye të tij është sekretari kuvendit, janë dy anëtarë të komisionit, zonja Synavere Rysha dhe z. Hajdar Beqa, është Mentori dhe zonjusha Kaltrina. Mendoj që këta duhet të kryejnë një raport të tyre sa më shpejt.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Besnik Bislimi